

B.E.K.O.J. (java 4 nga 6)

K – Konsumojmë kafe / vakte bashkë

Mirë se ke ardhur në festimin e kishës sonë, në serinë B.E.K.O.J. Gëzohem shumë që je këtu.

B.E.K.O.J.

Duke e parë me ngulm këtë akronim javë pas jave, synimi është si të kuptojë secili misionin, qëllimin që ka Jezusi për jetën e tij, saj. Sepse Perëndia na ka bekuar që të jemi bekim.

Unë do të bekoj ... dhe të gjithë njerëzit e tokës do të bekohen nëpërmjet teje. Do të bekoj që të jesh bekim. Zanafilla 12:2-3.

Cilat ishin hapat e pare? Thamë që e para ishte:

B. Bjer në gjunjët e lutjes.

Duke e filluar çdo ditë të këtyre javëve me pyetjet: Si të bekoj dikë sot? Çfarë të bëj diçka për dikë sot?

Shkronja tjetër e akronimit nga fjala "Bekoj" është **E**:

E. E dëgjoj tjetrin. Për të kuptuar sesi ta bekosh dikë, duhet të jesh dëgjues, të dëgjosh qëllimisht për ta kuptuar sesi ta bekosh dhe se çfarë të bësh për të.

(opsionale:

Pyeta disa nga ju sesi ju ka përdorur Perëndia për të bekuar dikë dhe se çfarë keni dëgjuar dhe ju thatë:

Shkronja tjetër e fjalës "**B.E.K.O.J**" është **K**, që do të shikojmë sot. Ky është një aspekt që na vjen natyrshëm, por është e rëndësishme t'i japim një kuptim të ri dhe nëpërmjet saj të kuptojmë cili është misioni që Jezusi ka për ne.

K. Konsumojmë kafe / vakte bashkë

A ke dëgjuar ndonjëherë të dielën në kishë të flitet për këtë gjë, për vaktet dhe kafënë? Duket si pa lidhje, apo jo? Le që po afrohet dreka, mos na fol për të ngrënit, se po na bie sheqeri; duam të hamë pastaj.

Kur mendon Jezusin gjatë kohës së tij në tokë, çfarë ishin disa nga gjërat që bënte Ai? Shumë prej nesh do të thoshin: Ai mësonte të tjerët për Perëndinë, shëronte, bënte mrekulli, lutej, ecte mbi ujë, vdiq në kryq, u ringjall. A e ke menduar ndonjëherë se pjesë e misionit të Tij në tokë ishte edhe ngrënia e vakteve me të tjerët?

Jezusi hante vakte me qëllim

Po ku e gjejmë? Ja ku është një histori e preferuar për mua ku Jezusi është duke ngrënë me të tjerë, me Mateun dhe shoqërinë e Mateut.

Mateu 9:9 *Pastaj Jezusi, duke shkuar tutje, pa një burrë që rrinte në doganë, i quajtur Mate, dhe i tha: Ndiqmë! Dhe ai u çua dhe e ndoqi.*

Mateu 9:10 *Dhe ndodhi që, kur Jezusi u ul në tryezë në shtëpi, erdhën shumë tagrambledhës dhe mëkatarë dhe u ulën në tryezë bashkë me të dhe me dishepujt e tij.*

Mateu 9:11 *Farisenjtë, kur e panë këtë, u thanë dishepujve të tij: ``Pse Mësuesi juaj ha bukë me tagrambledhësit dhe me mëkatarët?``*

Mateu 9:12 *Jezusi, mbasi i dëgjoi, u tha atyre: ``Nuk janë të shëndoshët ata që kanë nevojë për mjekun, por të sëmurët.*

Mateu 9:13 *Tani shkoni dhe mësoni ç`do të thotë: "Unë dua mëshirë dhe jo flijime". Sepse unë nuk erdha për të thirrur në pendim të drejtët, por mëkatarët``.*

Jezusi po ecte rrugës dhe takoi një burrë te dogana, një taksambledhës që po rrinte aty në rrugë me një tavolinë, sepse kështu e kishte zyrën ai person. Dhe i tha një fjalë jetë-ndryshuese: "Ndiqmë!"

E kam thënë edhe një herë tjetër: taksambledhësit ishin llumi i shoqërisë në atë kohë, sepse u merrnin njerëzve taksa për t'ua dhënë Romakëve që ishin pushtues, dhe plus kësaj nxirrnin edhe pagën e tyre nga mënyra korruptive. Se kë më kujtojnë? Me kë do i krahasojë?

Tani, nuk jemi vend i korruptuar, ç`është ajo fjalë, por cila është një lloj pune që ngjan me taksambledhësit e asaj kohe? Ata që vijnë të të presin dritat kur ke një muaj pa paguar? Apo policët e bashkisë që i marrin sallatat nënave? Apo policët rrugorë që ku të gjejnë rastin, të vendosin ndonjë gjobë? Apo atë mësuesin që merr kaq lek për të kaluar te ajo lënda e vështirë?

Më thuaj ndonjë tjetër që ti sheh të ngjashëm.

Jezusi nuk i tha: "Tani që po më ndjek, do të bëjmë disa trajnime bashkë, do të mësojmë këtë e atë." Ai shkoi në shtëpinë e Mateut për të ngrënë me të. Dhe a e di kush erdhi për drekë në shtëpinë e Jezusit? Koleget e tij taksambledhës. Në kontekstin e asaj kohe, këta ishin "mëkatarët" më të mëdhenj, krahasuar me mëkatin e prostitutave. Kur Jezusi po hante me ta në shtëpinë e tyre, quhej skandal i madh.

Të ngrënit në atë kohë kishte shumë kuptim, nuk është si sot, kur thua "a ke ngrënë?" dhe merr ndonjë byrek me vrap rrugës dhe një bidon me dhallë, ose ca qofte, ose gjysmë pice. Jo, kur uleshe për të ngrënë me dikë, kjo nënkuptonte se së pari kishe dëshirë të shoqërohesh me të. E vlerësoje atë person. Personat me të cilët haje bukë ishin persona që i doje dhe i vlerësoje, ishin shoqëria e ngushtë. Prandaj, kur lexon ungjijtë, do të vëresh që Jezusi shpesh është duke ngrënë me dikë dhe shpesh ishin njerëz të lënë pas dore nga shoqëria.

Sigurisht që fetarëve të asaj kohe, iu iku truri kur panë Jezusin duke ngrënë me taksambledhësit. Dhe iu thanë dishepujve të tij:

Mateu 9:11 *Farisenjtë, kur e panë këtë, u thanë dishepujve të tij: 'Pse Mësuesi juaj ha bukë me tagrambledhësit dhe me mëkatarët?'*

Por Jezusit ia zuri veshi fjalët e tyre dhe iu përgjigj Jezusi vetë aty. Ma do mendja, ngase ishin për të drekë, Jezusi me ndonjë një kofshë pule në dorë, tha:

Mateu 9:12 *Jezusi, mbasi i dëgjoi, u tha atyre: 'Nuk janë të shëndoshët ata që kanë nevojë për mjekun, por të sëmurët.'*

Ai po tregonte shumë qartë: "Unë kam një mision dhe jam duke e ndjekur atë, të ngrënit është pjesë e asaj që bëj, por ju s'po e kapni fare se çfarë po bëj unë."

Mateu 9:13 *Tani shkoni dhe mësoni ç'do të thotë: "Unë dua mëshirë dhe jo flijime". Sepse unë nuk erdha për të thirrur në pendim të drejtët, por mëkatarët`.*

Ai citon një varg nga Dhjata e Vjetër, sepse Farisenjtë e njihnin mirë atë pjesë të Shkrimit: "Ju nuk e keni idenë e asaj që ka thënë Perëndia; unë dua mëshirë ndaj atyre në nevojë, jo llafë të bukura dhe fasada." Dhe po u thoshte: "Ju duhet t'i vini në praktikë ato vargje të Biblës që i dini shumë mirë, sesi janë dhe çfarë kuptimi kanë."

Jezusi tha gjithashtu dhe një gjë tjetër te **Luka 7:34-35**

Erdhi Biri i njeriut që ha dhe pi, dhe ju thoni: "Ja grykësi dhe pijaneci, miku i

tagrambledhësve dhe i mëkatarëve". Por urtisë i japin të drejtë gjithë bijtë e saj``.

Jezusi nuk ishte as grykës, as pijanec. Ai nuk ishte i lëshuar sysh për bukë. Por rregullisht ulej dhe hante e pinte me njerëzit dhe e akuzonin për këtë gjë.

E veçanta e Jezusit nuk ishte se Ai hante sepse duhet të hante, i shkonte ora, i vinte uri dhe ulej te shtëpia që kishte më afër. Jo, të ngrënit me të tjerët ishte pjesë e misionit të Tij për të krijuar marrëdhënie dhe për t'u miqësuar me ta.

Jezusi shkonte për të ngrënë me qëllim, nuk ishte se kishte ngelur pa bukë.

Po ne, si të hamë vakte ose të pimë kafe me dikë me qëllim në mendje? Ne e kemi më të lehtë të pimë kafe me dikë sesa të hamë.

(shënim për pastorin:

opsionale:

Kjo seri do jetë me life-story të ndryshme (të lidhura drejtpërdrejt me mesazhin), dua të ftoj persona që do të ndajnë momente nga jeta e tyre në lidhje me: të konsumuarit kafe me dikë në mënyrë të qëllimshme.

Djali/vajza, si inicion kohën për kafe me njerëz të ndryshëm, shoqe, njerëz te grupi yt i vogël ose njerëz te lagja. Si e gjen kohën për ta, si i ke përfshirë te grupi i vogël? Po vakte a hani bashkë? Si ka funksionuar?)

Po ne, si të konsumojmë vakte ose kafe me qëllim?

Të Konsumosh Vakte / Kafe me Qëllim

Me qëllim do të thotë që ndërkohë që hani ose pini kafe bashkë, të ndërtohet miqësinë me ta ose të forcosh atë miqësi që ke. Njerëzit janë më të lirshëm për të biseduar kur janë duke ngrënë ose pirë diçka.

Kur pyeta një pastor nga Hollanda se ku ndodhin grupet e vogla, më tha që i bënë në shtëpi. "Si ka mundësi," i thashë, "se te ne, megjithëse mbahemi si njerëz me bujari të lartë, nuk është se kemi qef të na vijmë njerëz në shtëpi." Prandaj, u themi prit, mire se erdhe, pimë një kafe aty poshtë pallatit, sepse ne jemi në pallat dhe 2-3 kafe janë aty." Ai tha, "Takohen nëpër shtëpi, dhe është kulturë që e ka ndërtuar kisha jonë, nuk është në kulturën Hollandeze. Madje në kulturën tonë, nëse shkon te dikush për darkë, ai ta thotë troç, nuk kam blerë ushqim edhe për ty, kështu që nuk mund të vish për darkë te unë." Por kisha ka krijuar një kulturë të re, të shkuarit nëpër shtëpi dhe krijimin e grupeve të vogla nëpër shtëpi.

Mund të funksionojë edhe për ty.

Çfarë mund të ndodhë nëse secili nga ne takohet javën që vjen për të pirë kafe ose për të ngrënë drekë me dikë, ose fton për darkë dikë që nuk është nga kisha?

Do ta bekojmë botën duke ngrënë dhe duke pirë kafe.

Nëse është kaq e nevojshme, atëherë le të shikojmë se çfarë pengesash na dalin, pse e kemi siklet.

Pengesat që dalin në lidhje me Konsumimin e Vakteve / Kafeve

Ndoshta ti mendon: “Po mo, po, e ke në terezi ti, është kollaj për ta thënë, është vështirë për ta praktikuar.” Unë për vete kam shumë POR, POR që më vijnë në mendje.

Por unë s’kam kohë...

Unë po nuk gjej kohë të ha me familjen time, s’gjej kohë të pi një kafe me gruan time, me shoqen e vjetër, shokun e ngushtë. Unë e marr dhe bukën me vete dhe marr sa për vete, nuk del për dy veta.

Po sikur ta provosh? Bëje një provë këtë javë. Mos u dorëzo, por bëje një provë dhe gjej një mundësi për të ftuar dikë që nuk është në kishën tonë për një kafe dhe një bisedë, qoftë dhe në shkollë ose në punë. Uluni dhe hani bashkë.

Por unë se di se çfarë të flasim...

Ja, u ulem, por nga t’ia nis, se unë s’jam as i gojës. Mos e vrit mendjen shumë, fol me fjalët e tua, si besove dhe çfarë ndryshimesh ka bërë Zoti në jetën tënde. Natyrshëm. Pa siklet, pa shumë llafe të bukura, fol si në një ditë normale.

Por unë s’kam dëshirë të ftoj njerëz të tjerë...

Duhet të shkëlqejë shtëpia, duhet të lahen të gjitha ato enë, duhet të gatuj diçka; unë i bie shkurt në darkë, ose pilaf ose makarona. Pastaj do lahen enët përsëri kur të ikin ata nga shtëpia jonë.

Për këtë kam një përgjigje të shpejtë: kërkoje burrit të lajë enët, po ftuat njerëz për darkë. “Kur të ikin ata, do i lash ti enët, jo t’i lash enët kur janë ata, që të dukesh gjasme si burrë i mirë, jo, jo, kur të ikin ata njëherë. Se kam dhe nja dy tigane nga dreka pa larë.”

Kur vjen puna tek të ngrënit me qëllim dhe të pirit kafe me qëllim, natyrshëm të vjen justifikimi, po, e di sa shpejt që të vjen. “Po është e sikletshme, po unë s’kam, unë s’di.”

Po unë mendoj dhe besoj që ia vlen ta provosh këtë javë. Ulu me dikë që nuk vjen në kishë për të pirë kafe ose për të ngrënë diçka dhe kjo do të bëhet pjesë e asaj që ti po kërkon për të gjetur dhe kuptuar cili është misioni i Jezusit për jetën tënde.

B.E.K.O.J.

Nëse e ke marrë seriozisht për të bekuar njerëzit që ke rreth e rrotull vetes, ke për t'ia gjetur anën. Dhe natyrshëm, do të gjesh veten duke ndihmuar të tjerët të gjejnë rrugën e kthimit te Perëndia.

K. Kosumojmë kafe / vakte bashkë

Hajde ta bëj një pyetje, një çikë me spec. Çfarë do të bëje ti, nëse do e dije që e vetmja gjë që ndihmonte shokun, shoqen, të afërmin për të njohur Perëndinë, do të ishte një kafe me ty ose një vakt me ty?

Nëse kjo do të ishte e vërtetë, çfarë do të bëje? Ti nuk e ke idenë se çfarë mund të ndodhë kur ti bën pjesën tënde.

Për ju që jeni në grup të vogël, organizoni diçka bashkë. Bëni një BBQ (barbeque) ose një pasdite të hapur me lojëra dhe çdo person të ftojë një shok/shoqe të re në grup.

Tendenca është që të harrosh atë që dëgjove sot, pa dalë nga dera. Dua të të sfidoj: bëj diçka, mendo për dikë, kur do e takosh, kur do i shkruash, ose telefonosh.

Le të konsumojmë kafe ose vakte me dikë këtë javë, të paktën me një.

Le të lutemi